



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më 30.11 2023

_VENDIM

Nr. 25, DATË 24.11.2023

PËR

NJË SAKTËSIM NË VKB NR.93 DATË 28.08.2023 PËR DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR PUBLIK PËR (VEPRAT E MARRJES + DEKANUESIT, BASENET E PRESIONIT DHE GODINAT) E HEC-VE "ZGALLO 1 & ZGALLO 2" NGA SHOQËRIA "AUTOVISION AL" SHPK.

Ligji Nr.8417, date 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pika 1 dhe pika 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomies vendore", të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", pikes 2 të nenit 8, pikën 1.2 të nenit 9, pikës 5 të nenit 27 dhe gjërës "e" të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligji Nr.8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", pikës 4 të nenit 5 të Ligjit Nr.57/2020, "Për Pyjet", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.888, datë 27.12.2022, "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në Nr. 433, datë 08.06.2016, "Për transferimin sipas listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Mjedisit në pronësi të ish komunave/bashkive", pikes 23 të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor publik", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.559, datë 29.07.2022, "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore". Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 22 date 09.01.2008 "Per përcaktimin e procedurave dhe kritereve te Administrimit te pyllit Komunal, Vendimin e Këshillit te Ministrave Nr.510, date 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve te trupëzuara e te patrupëzuara", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1374, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor", Këshilli Bashkiak:



VENDOSI:

1. Të miratojë vazhdimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore prej **0.32 ha** pyll në ekonominë pyjore Bishnicë (Pjesa Ekonomike Uji i Ftohtë), në ngastra/nëngastrat pyjore nr.15/b (0.02 ha), nr.31a (0.02 ha) për godinat Hec-ve, për (veprat e marrjes + dekanuesit, basenet e presionit) nëngastra nr.3/a (0.03 ha), nr.7/c (0.005 ha), nr.9/b (0.035 ha), nr.10/a (0.02 ha), nr.11/a (0.045 ha), nr.11/d (0.03 ha), nr.17/d (0.03 ha), nr.33/c (0.085 ha) për ndërtimin e hec-ve Zgallo 1 & 2, nga shoqëria "AUTOVISION AL" SHPK.
2. Shprehja e dakortësisë do ti dërgohet Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, për vijimin e procedurave ligjore të heqjes nga fondi pyjor/kullosor.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike dhe Shërbimi Pyjor për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes publike (sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore").
5. U shpall sot më datë __. __.2023.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

